

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 20.06.2026

1. Më poshtë janë paraqitur pasqyrat financiare të Tuana SH.P.K. Si një kontrollues financiar ju keni për detyrë përgatitjen e pasqyrës së rrjedhjes së parasë. Kjo detyrë përfshin raportimin e saktë të hyrjeve dhe daljeve të parasë të kompanisë gjatë periudhës financiare duke siguruar pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Tuana SH.P.K.
Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023

	€'000
Të hyrat	4,000
Kostoja e shitjes	<u>(2,000)</u>
Fitimi bruto	2,000
Interesi i arkëtuar	60
Kostot e shpërndarjes	(300)
Kostot administrative	(400)
Kostot financiare	<u>(115)</u>
Fitimi para tatimit	1,245
Shpenzimi i tatimit në fitim	<u>(160)</u>
Fitimi i vitit	1,085

Tuana SH.P.K.
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor

	2023	2022
	€'000	€'000
Pasuritë jo-qarkulluese		
Prona, fabrika dhe pajisjet	600	350
Pasuritë jo-qarkulluese	350	300
Investimet	-	60
	950	710
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	170	110
Të arkëtueshmet	450	390
Investimet afatshkurtra	70	-
Paraja në dorë	4	3
	694	503
Total pasuritë	1,644	1,213
Detyrimet dhe Ekuiteti		
Ekuiteti		
Kapitali aksionar (1€ aksionet e zakonshme)	390	388
Premia në aksione	200	180
Teprica e rivlerësimit	120	100
Fitimet e mbajtura	380	70
	1,090	738

Detyrimet afatgjata		
Kredia afatgjatë	164	100
Detyrimet afatshkurtra		
Të pagueshmet	135	120
Overdrafti bankar	95	115
Tatimi i paguar	160	140
	554	475
Total detyrimet dhe ekuiteti	1,644	1,213

Shënimet shtesë:

- 1) Të hyrat nga shitja e një investimi në pasuri jo-qarkulluese arritën në vlerën 70,000€
- 2) Gjatë vitit Tuana SH.P.K. shiti pajisje që fillimisht kishin një kosto prej 100,000€. Në momentin e shitjes, këto pajisje kishin një vlerë neto kontabël prej 60,000€. Shitja gjeneroi të hyra prej 30,000€.
- 3) Më 31 dhjetor 2023, prona, fabrika dhe pajisjet e Tuana SH.P.K. kishin një kosto totale prej 1,000,000€. Kjo paraqet një rritje krahasuar me koston e vitit të kaluar prej 538,000€ më 31 dhjetor 2022. Zhvlerësimi i akumuluar për këto pasuri ishte 400,000€ më 31 dhjetor 2023, krahasuar me 188,000€ më 31 dhjetor 2022. Këto të dhëna ofrojnë informacion mbi investimet e kompanisë në pasuri jo-qarkulluese dhe shkallën e zhvlerësimit të tyre me kalimin e kohës.
- 4) Gjatë vitit, Tuana SH.P.K. emetoi aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 1€ për aksion. Këto aksione u emetuan me premi që do të thotë se çmimi i emetimit të secilit aksion ishte më i lartë se vlera e tij nominale. Si rezultat, kompania siguroi kapital shtesë nga kapitali aksionar, duke reflektuar preminë e arkëtuar mbi vlerën nominale të aksioneve.
- 5) Gjatë vitit, kompania shpërndau dividendë për aksionarët e saj. Kjo shpërndarje përfshinte shpërndarjen e një pjese të fitimeve të kompanisë tek mbajtësit e kapitalit si kthim nga investimi i tyre. Pagesa e dividendëve tregon angazhimin e kompanisë për të shpërblyer aksionarët dhe pasqyron profitabilitetin dhe gjendjen e saj të rrjedhjes së parasë. Shuma totale e dividendës së paguar u përcaktua në përputhje me politikën e dividendëve të kompanisë dhe fitimet e disponueshme për shpërndarje. Kjo pagesë është regjistruar në pasqyrat financiare.

Kërkohet:

Përgatitni pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin 31 dhjetor 2023, duke përdorur metodën indirekte.

(20 pikë)

Zgjidhja e problemit 1:

Tuana SH.P.K.	
Pasqyra e rrjedhjes së parashë më 31 dhjetor 2023	
	€'000
Aktivitetet operative	
Fitimi para tatimit	1,245
Shpenzimi i zhvlerësimit	252
Humbja nga shitja	30
Fitim nga shitja e investimit në pasuri jo qarkulluese	(10)
Të hyrat nga interesi	(60)
Shpenzimet e interesit	115
Rritja në stoqe	(60)
Rritja në të arkëtueshmet	(60)
Rritja në të pagueshmet	15
Paraja e gatshme e gjeneruar nga operacionet	1467
Interesi i paguar	(115)
Tatimi i paguar	(140)
Rrjedhja neto e parashë nga aktivitetet operative	1,212
Aktivitetet investuese	
Blerja e PFP	(542)
Pagesa për blerjen e pasurive jo-qarkulluese	(50)
Arkëtimet nga shitja e PFP	30
Arkëtime nga shitja e investimeve në pasuri jo-qarkulluese	70
Interesi i arkëtuar	60
Rrjedhja neto e parashë nga aktivitetet investuese	(432)
Aktivitetet financuese	
Emetimi i aksioneve	22
Shlyerja e kredisë	64
Dividenda e paguar	(775)
Rrjedhja neto e parashë nga aktivitetet financuese	(689)
Rrjedha neto e parashë dhe ekuivalentëve të parashë gjatë periudhës	91
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim (3-115)	(112)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund (4+70-95)	(21)

Llogaritjet

Zhvlerësimi i akumuluar

Zhvlerësimi i pasurisë së shitur	40	Saldo në fillim	188
Saldo në fund	400	Shpenzimi i zhvlerësimit (shifra balancuese)	252
	440		440

Prona, fabrika dhe pajisjet

Saldo në fillim	538	Shitja	100
Rivlerësimi (120-100)	20	Saldo në fund	1,000
Blerja (shifra balancuese)	542		
	1,100		1,100

Problemi 2

Pjesa a), b) dhe c) e detyrës janë te ndara

- a) (i) Shpjegoni dy (2) qëllime të llogarive kontrolluese **(2 pikë)**
(ii) Shënoni dhe shpjegoni katër (4) gabime që nuk do të ndikojnë në balancimin e bilancit vërtetues **(4 pikë)**
- b) Bilanci vërtetues i Tregtia SH.P.K. kishte një tepricë të kredisë mbi debinë në vlerë prej 12,500€. Është hapur një llogari pezull për të balancuar llogaritë. Transaksionet e mëposhtme u zbuluan më vonë:
- (1) Shitjet prej 4,000€ nuk ishin regjistruar fare në regjistrat e shitjeve, është harruar e tere fatura te regjistrohet.
 - (2) Blerja e lëndëve të para prej 4,005€ ishte regjistruar në llogarinë e blerjeve si 4,500€
 - (3) Interesi i paguar prej 6,000€ dhe interesi i arkëtuar prej 9,000€ ishin regjistruar në anën e gabuar në bilancin vërtetues.
 - (4) Balanca e llogarisë së kontrollit të debitorëve prej 224,387€ ishte përfshirë në bilancin vërtetues si 242,387€.
 - (5) Balanca në llogarinë rrjedhëse me vëllain e pronarit ishte lënë jashtë bilancit vërtetues. Ky zë, së bashku me efektet e gabimeve në pikat (i) deri (iv) kur të korrigjohen, do të mbyllin llogarinë pezull.

Kërkohet:

Hapni një llogari pezull dhe korrigjoni transaksionet e mësipërme. **(4 pikë)**

c) Shqiponja SH.P.K. përgatiti harmonizimin bankar të tetorit 2025 për rishikim nga auditorët. Më 31 tetor 2025, gjendja në librin kryesor ishte 2,450€ (kredi), ndërsa pasqyra bankare tregonte se kompania kishte mjete në shumën 3,743€.

Shënimet shtesë:

- (1) Drejtori ekzekutiv i Shqiponja SH.P.K. transferoi shumën 3,000€ nga llogaria e tij personale bankare në llogarinë e kompanisë. Banka e realizoi transferimin më 31 tetor 2025, por Shqiponja SH.P.K. nuk kishte bërë asnjë regjistrim në librat e saj.
- (2) Një çek i pagueshëm për ZOIN në shumën 5,600€, i lëshuar dhe i regjistruar saktë në pasqyrat bankare, në librin e Shqiponja SH.P.K. ishte regjistruar si 6,500€.
- (3) Çekët e mëposhtëm të lëshuar nga Shqiponja SH.P.K. në tetor 2025 nuk u shfaqën në pasqyrën bankare për atë muaj:
 - Çek #00123 – 2,000€
 - Çek #00124 – 4,800€
 - Çek #00144 – 5,250€
- (4) Tre çeqe të marra dhe të depozituara nga Shqiponja SH.P.K. në shumën totale 4,800€ nuk janë kredituar nga banka.
- (5) Të ardhurat nga investimet, të shoqëruara me njoftim nga banka në shumën 2,457€, nuk janë regjistruar nga banka deri më 3 nëntor 2025.
- (6) Kompania bëri të mundur që banka të transferonte 500,000€ tek një furnizues në Shqipëri. Një tarifë prej 0.5% për këtë transfer nuk është regjistruar në librat e Shqiponja SH.P.K.

Kërkohet:

- (i) Përgatitni llogarinë bankare në librin e madh të Shqiponja SH.P.K., duke përfshirë çdo regjistrim rregullues bazuar në informacionet e mësipërme.

(4 pikë)
- (ii) Përgatitni harmonizimin e bilancit të pasqyrës bankare që tregon bilancin e korrigjuar në llogarinë bankare në librin nominal të Shqiponja SH.P.K.

(4 pikë)
- (iii) Përshkruani një emetim bonusi dhe një emetim të drejtash; duke deklaruar qartë se cili prej të dyve do të favorizohej nga një njësi që ka plane për zgjerimin e operacioneve të saj.

(2 pikë)

(Total 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 2:

(a)

(i) *Qëllimet e llogarive kontrolluese*

- Përdoren për të gjetur dhe zbuluar gabimet. Kjo ndodh kur llogaritë kontrolluese nuk përputhen me llogaritë e librit të madh, duke lehtësuar hetimin dhe identifikimin e gabimeve.
- Përdoren për të siguruar gjendjet e debitorëve dhe kreditorëve për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Ofron një mekanizëm për parandalimin e mashtrimeve, pasi ndarja e detyrave është një veçori kryesore e sistemit të llogarive kontrolluese. Kjo mundëson kryerjen e kontrolleve dhe verifikimeve të ndërsjella mbi punën e secilit individ.

(ii)

- **Gabimi i mosregjistrimit të plotë** – Mosregjistrimi i një transaksioni. Kur një transaksion lihet tërësisht pa u regjistruar (në debi dhe kredi), ai nuk ndikon në barazimin e bilancit vërtetues.
- **Gabimet që thjeshtojnë njëra tjetrën**– Gabime që janë të barabarta në vlerë dhe me efekt të kundërt ndaj njëra-tjetrës. Për pasojë, ato nuk ndikojnë në barazimin e bilancit të vërtetues.
- **Gabimi i regjistrimit në llogari të gabuar** – Një transaksion regjistrohet në llogarinë e gabuar, por brenda kategorisë së duhur. Për shembull, shpenzimet e energjisë elektrike regjistrohen si shpenzime telefoni. Ky gabim nuk ndikon në barazimin e bilancit të vërtetues.
- **Gabimi i parimit** – Një transaksion regjistrohet në klasën e gabuar të llogarive. Për shembull, një shpenzim i të ardhurave trajtohet si shpenzim kapital.

(b) Llogaria pezull

	Debi	Kredi
	€	€
Diferenca në libra	12,500	
Interesi i paguar	12,000	
Interesi i arkëtuar		18,000
Të arkëtueshmet e mbivlerësuara		18,000
Mbivlerësimi i blerjeve		495
Llogaria rrjedhëse me vëllain (shif.bal.)	11,995	-
	<u>36,495</u>	<u>36,495</u>

c) Harmonizimi bankar i Shqiponja SH.P.K.

Libri i arkës	
1) 3000	Saldo e pakorrigjuar 2,450
2) 900	6) 2500
	Saldo e korrigjuar 1050

Ekstrakti bankar

Saldo e pakorrigjuar 3,743

3) Ceqet e paparaqitura (2,000)

(4,800)

(5,250)

4) +4,800

5) +2,457

Saldo e korrigjuar -1,050

iii) Përshkrimi i emetimit bonus dhe emetimit me të drejta, si dhe emetimi më i përshtatshëm për zgjerim

Emetimi bonus është emetimi i aksioneve falas për aksionarët ekzistues. Aksionarët nuk paguajnë për këto aksione dhe ato shpërndahen në përpjesëtim me aksionet që ata zotërojnë. Ky veprim është thjesht një mënyrë për kompaninë që të kapitalizojë rezervat e saj dhe të rrisë numrin e aksioneve në qarkullim.

Emetimi me të drejta është një ofertë nga kompania për t'u emetuar aksione të reja aksionarëve ekzistues në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre aktuale në kapital. Këto aksione zakonisht ofrohen me një çmim më të ulët se vlera e tyre në treg.

Një kompani që planifikon zgjerimin e aktiviteteve të saj do të favorizonte emetimin me të drejta, sepse ky emetim siguron para të gatshme për kompaninë. Në të kundërt, emetimi bonus nuk sjell fonde të reja dhe për këtë arsye nuk siguron kapitalin e nevojshëm për zgjerim.

Problemi 3

Zambaku, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, paraqiti bilancin vërtetues të mëposhtëm më 31 dhjetor 2023:

	Debi	Kredi
	€'000	€'000
Investimet afatgjata	10,000	
Aksione preferenciale 10% (0.50€ secila)		1,000
Llogaria pezull		1,500
Premia në aksione		1,000
Rezerva e rivlerësimit më 1 janar 2023		350
Aksionet e zakonshme (1€ secila)		21,000
Nota kreditore 12%		2,500
Toka	4,950	
Ndërtesa- me kosto	3,500	
Zhvlerësimi i akumuluar me 1 janar 2023		200
Makineria dhe pajisjet-me kosto	2,200	
Zhvlerësimi i akumuluar me 1 janar 2023		300
Stoqet me 1 janar 2023	2,100	
Të arkëtueshmet	8,750	
Paraja në dorë	4,520	
Të pagueshmet		3,180
Overdrafti bankar		900
Shpenzimet administrative	2,640	
Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes	2,920	
Dividentat e paguar	350	
Interesi i paguar i notës kreditore	150	
Të hyrat nga shitja		36,000
Blerjet	29,450	
Transporti i blerjeve	150	
Transporti i shitjeve	100	
Kthimet nga blerjet		340
Zbritje të lejuara dhe të pranuar	80	1,690
Fitimet e mbajtura më 1 janar 2023		1,900
TOTAL	71,860	71,860

Shënime shtesë:

- (1) Një (1) milion aksione të reja të zakonshme u emetuan me një premi prej 0.5€ më 1 tetor 2023. Të ardhurat nga emetimi janë lënë në një llogari pezull.
- (2) Parapagimet e shpenzime administrative ishin 120,000€ dhe akrualet e shitjes dhe shpërndarjes ishin 170,000€.
- (3) Zambaku përdor modelin e rivlerësimit siç lejohet nga SNA 16 – Pronat, fabrika dhe pajisjet. Specialistët e pavarur të vlerësimit të tokës me bazë në Shqipëri kanë rekomanduar që toka të rivlerësohet në 6,000,000€.

- (4) Zhvlerësimi do të llogaritet si mëposhtë:
- i. Ndërtesat me 4% në vit mbi koston e tyre fillestare.
 - ii. Makinaria dhe pajisjet me 10% në vit mbi vlerën e tyre kontabël
- (5) Duhet të paguhet tatimi i fitimit në vit prej 1,080,000€.
- (6) Nota kreditore me 12% u ble më 1 korrik 2023. 1,500,000€ e kësaj note është e shlyeshme deri më 31 dhjetor 2024 dhe 1,000,000€ deri më 30 qershor 2040.
- (7) Një klient ka ndërprerë aktivitetin dhe i detyrohet kompanisë 280,000€; ky borxh nuk pritet të arkëtohet dhe duhet bërë rregullimi për borxh të keq.
- (8) Stoqet në fund të periudhës janë vlerësuar në 1,940,000€, ndërsa vlera neto e realizueshme është 1,950,000€.
- (9) Aksionet preferenciale janë aksione të riblershme dhe dividendët preferencialë për vitin ende nuk janë regjistruar.
- (10) Investimet afatgjata fitojnë një normë interesi fikse vjetore prej 10%. Ne datën e Bilancit të gjendjes, këto te hyra nuk janë arkëtuar nga kompania.

Kërkohet:

Përgatitni të mëposhtmet:

- (a) Pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2023. (10 pikë)
- (b) Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023. (10 pikë)

(Total 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

a)

Zambaku: Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2023	
	€'000
Të hyrat nga shitja	36,000
Kostoja e shitjes (llog. 1)	(29,420)
Fitimi bruto	6,580
Të hyrat tjera (zb.pranuara 1,690+ int.i inv.1,000 (10,000*10%))	2,690
	9,270
Shpenzimet administrative (2,640-120)	(2,520)
Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes (2920+170)	(3,090)
Interesi i notës kreditore (llog.4)	(150)
Transporti i shitjes	(100)
Shpenzimet e zhvlerësimit (llog.2 dhe 3, 140+190)	(330)
Borxhet e këqija	(280)
Zbritja e lejuar	(80)
Fitimi para tatimit	2,720
Tatimi në fitim	(1,080)
Fitimi i vitit	1,640

b)

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023

	€'000
Pasuritë jo-qarkulluese	
Investimet afatgjata	10,000
Toka	6,000
Ndërtesa (llog. 2)	3,160
Makineria dhe pajisjet (llog.3)	1,710
	20,870
Pasuritë qarkulluese	
Stoqet	1,940
Të arkëtueshmet (8,750-280)	8,470
Interesi i arkëtueshem	1,000
Parapagimi i shpenzimeve administrative	120
Paraja	4,520
	16,050
Total pasuritë	36,920
Detyrimet dhe Ekuiteti	
Detyrimet afatgjata	
Aksionet preferenciale	1,000
Nota kreditore 12%-Pjesa afatgjate	1,000
Detyrimet afatshkurtra	
Të pagueshmet	3,180
Nota kreditore -pjesa afatshkurter	1,500
Overdrafti bankar	900
Dividentat preferenciale e pagueshme (10%*1000)	100
Akrualet e shitjes dhe shpërndarjes	170
Tatimi në fitim i pagueshem	1,080
	6,930
Ekuiteti	
Aksionet e zakonshme (21,000+1,000)	22,000
Premia në aksione (1,000+500)	1,500
Rezerva e rivlerësimit (350+1,050)	1,400
Fitimet e mbajtura (llog. 6)	3,090
	27,990
Total detyrimet dhe ekuiteti	36,920

Llogaritjet:

1)

Kostoja e shitjes	
Stoqet në fillim	2,100
Blerjet (blerjet 29,450+transporti 150- kthimet 340)	29,260
Stoqet në fund	(1,940)
	29,420

2)

Ndërtesa	
Kostoja	3,500
Zhvlerësimi i akumuluar	(200)
Shpenzimet e zhvlerësimit (4%*3,500)	(140)
	3,160

3)

Makineria dhe pajisjet	
Kostoja	2,200
Zhvlerësimi i akumuluar	(300)
Shpenzimet e zhvlerësimit 10%*(2,200-300)	(190)
	1,710

4) Interesi i notës kreditore= $2,500 \times 12\% \times 6/12 = 150$

5) **Fitimet e mbajtura**= Gjendja në fillim+ Fitimi i vitit- Dividentat=

=1,900+1,640-350-100 (Div preferenciale)=3,090

6)

	Debi	Kredi
Llogaria pezull	1,500	
Kapitali aksionar		1,000
Premia në aksione		500

Problemi 4

Kontabilisti i kompanisë Oqeani shpk, ka kërkuar që ju si këshilltar t'i përgatitni disa informata në lidhje me llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme. Kompania ju ka ofruar informatat si në vijim:

- (i) Saldo fillestare në llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme ishte si në vijim:

Llogaritë e arkëtueshme:	Debi	€56,247
Llogaritë e pagueshme:	Kredi	€68,164

- (ii) Në vijim janë transaksionet të cilat kanë ndodhur për vitin i cili përfundon më 31 dhjetor 2025 në lidhje me llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme:

	€
Shitjet me afat/kredi	345,812
Shitjet me para të gatshme	10,845
Blerjet me afat/kredi	220,541
Kthimet e shitjeve me afat/kredi	6,475
Kthimet e blerjeve me afat/kredi	20,169
Kontra hyrjet	15,467
Zbritjet e lejuara	14,852
Zbritjet e marra	23,253
Shumat e paguara në para të gatshme për llogaritë e pagueshme	194,652
Shumat e arkëtuara në para të gatshme nga llogaritë e arkëtueshme	362,145
Borxhet e këqija	1,571
Lejimet për borxhet e dyshimta	1,854

Kërkohet:

- (a) Përgatitni Llogarinë Kontrolluese të të Arkëtueshmeve dhe Llogarinë Kontrolluese të të Pagueshmeve, për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025,

(8 pikë)

- (b) Përgatini hyrjet në ditar për të gjitha transaksionet nën (ii) si më lartë, duke supozuar se asnjë transaksion nuk është regjistruar deri më tani.

(12 pikë)

(Totali: 20 Pikë)

a)	Debi	Llogaria kontrolluese e të pagueshmeve €	Kredi €
		Saldo në fillim	
	Kthimet e blerjeve	20,169	Blerjet me kredi 68,164
	Kontrahyrjet	15,467	220,541
	Zbritjet e marra	23,253	
	Paraja e gatshme	194,652	
	Saldo balancuese	<u>35,164</u>	-
		<u>288,705</u>	<u>288,705</u>
		Saldo përfundimtare	<u>35,164</u>
	Debi	Llogaria kontrolluese e të arkëtueshmeve €	Kredi €
	Saldo në fillim	56,247	
	Shitjet me kredi	345,812	Kthimet e shitjeve 6,475
			Kundërhyrjet 15,467
			Zbritjet e lejuara 14,852
			Paraja e gatshme 362,145
			Borxhet e këqija 1,571
			Saldo balancuese 1,549
		<u>402,059</u>	<u>402,059</u>
	Saldo përfundimtare	1,549	

Shënim: Shitjet me para të gatshme nuk përfshihen në LL/A, Lejimet për borxhet e dyshimta janë konto e ndarë e cila paraqitet në B/Gj.

b)	D. LL/ A	345,812	
	K. Të hyrat nga shitja		345,812
	D. Paraja e gatshme	10,845	
	K. Të hyrat nga shitja		10,845
	D. Blerjet	220,541	
	K. LL/ P		220,541
	D. Kthimet e shitjeve	6,475	
	K. LL/ A		6,475
	D. LL/ P	20,169	
	K. Kthimet e blerjeve		20,169
	D. LL/ P	15,467	
	K. LL/ A		15,467
	D. Zbritjet e lejuara	14,852	
	K. LL/ A		14,852
	D. LL/ P	23,253	
	K. Zbritjet e marra		23,253
	D. LL/ P	194,652	
	K. Paraja e gatshme		194,652

D.	Paraja e gatshme	362,145	
K.	LL/ A		362,145
D.	Shpenzimet e borxheve të këqija	1,571	
K.	LL/ A		1,571
D.	Shpenzimet e borxheve të dyshimta	1,854	
K.	Lejimet për borxhet e dyshimta		1,854

Problemi 5

Shënim: Kjo pyetje është e ndarë në dy pjesë: Pjesa 1 dhe Pjesa 2. Ju duhet të mbani parasysh se ndërmarrjet e paraqitura në të dy pjesët, janë të ndara dhe nuk janë të lidhura me njëra tjetrën.

Pjesa 1: Znj. Nora, drejtoreshë menaxhuese e Nora Sh.p.k. ka një numër pyetjesh në lidhje me stoqet dhe ju ka kërkuar juve të e këshilloni duke u bazuar në SNK 2 – Stoqet. Si pjesë e inventarit të saj të përgjithshëm, Nora Sh.p.k. ka tre artikuj të stoqeve, kostot dhe vlera neto e realizueshme (VNR) e të cilëve është si në vijim:

Artikulli	Kosto - €	VNR - €
1	72	80
2	56	48
3	<u>92</u>	<u>96</u>
	220	224

KËRKOHET:

- a) Kalkuloni vlerën në fund të secilit artikull të stoqeve dhe si rrjedhojë edhe vlerën totale të stoqeve në fund të Nora sh.p.k. **(4 pikë)**
- b) Në kontekstin e SNK 2 – *Stoqet*, përgatitni një raport për Znj. Nora, i cili:
 - i) Përshkruan artikujt që e përbëjnë inventarin (stoqe);
 - ii) Shpjegoni se si maten/vlerësohen stoqet;
 - iii) Ofroni tre shembuj të kostove të cilat në mënyrë specifike përjashtohen (nuk përfshihen) në kostot e stoqeve, por njihen si shpenzime në periudhën në të cilën kanë ndodhur;
 - iv) Shkurtimisht diskutoni tre situata në të cilat vlera neto e realizueshme ka gjasa të jetë më e vogël se kosto. **(12 pikë)**

Pjesa 2: Stoqet në fund më 31 dhjetor 2025 të Dafina Sh.p.k. janë 347,841€. Kjo shumë përfshinë artikuj në vlerë prej 4,640€ të cilat ishin shkatërruar aksidentalisht më 31 dhjetor 2025, pasi që numërimi kishte përfunduar. Në atë shumë ishin të përfshira gjithashtu artikuj në vlerë prej 2,980€ të dëmtuar në tetor 2025, artikuj të cilët mund të ripërpunohen me një kosto prej 680€ dhe të shiten pastaj me një çmim prej 2,410€.

KËRKOHET:

Kalkuloni vlerën e stoqeve në fund të Dafina sh.p.k.. **(4 pikë)**

[Total: 20 pikë]

Problemi 5

Për: Znj. Nora, Drejtoreshë menaxhuese e Nora sh.p.k.

Nga: Tekniku i Kontabilitetit

Tema: SNK 2 – Stoqet

Data: Qershor 2026

- a) Sipas SNK 2 – Stoqet, stoqet vlerësohen sipas Kostos ose Vlerës Neto të Realizueshme cilado që është më e ulëta. Stoqet me vlerë prej 212€ janë stoqet në fund për biznesin tuaj.

Artikulli	Kosto - €	VNR - €	Më e ulëta - €
1	72	80	72
2	56	48	48
3	<u>92</u>	<u>96</u>	<u>92</u>
	220	224	212

- b) i) Artikujt që i përbëjnë stoqet sipas SNK 2 janë:

1. Mallrat
2. Lënda e parë
3. Materialet
4. Puna në progres
5. Produktet e gatshme të prodhuara

ii) Stoqet maten/vlerësohen sipas kosto ose vlerës neto të realizueshme, cilado që është më e ulëta.

iii) Paragrafi 16 i SNK 2 nënvizon shembujt e kostove të cilat janë të përjashtuara nga kosto e stokeve dhe të cilat njihen si shpenzimet të periudhës në të cilën kanë ndodhur, psh:

1. Shpenzimet e tepërta për materialet e humbura, të punës ose kostove tjera të prodhimit;
2. Shpenzimet e magazinimit, përveç nëse këto shpenzime janë të nevojshme në procesin e prodhimit, kur prodhimi është në fazë, si pjesë e një faze të prodhimit para fazës tjetër të mëtutjshme;
3. Shpenzimet administrative të cilat nuk kontribuojnë në sjelljen e stokeve në vendin dhe gjendjen aktuale; dhe
4. Shpenzimet e shitjes.

iv) Situatat në të cilat vlera neto e realizueshme ka gjasa të jetë më e vogël se kosto e stokeve është kur:

- / , Ka ndodhur një rritje në kosto ose një rënie në çmimin e shitjes;
- 0, Dëmtimi fizik i stokeve;
- 1, Vjetërsimi i produkteve;

- 2, Vendimi, si pjesë e strategjisë së ndërmarrjes për prodhimin dhe shitjen e produkteve me humbje;
- 3, Gabimet në prodhim ose blerje.

Për informata shtesë, ju lutem mos hezitoni të më kontaktoni!

Me respekt,

Tekniku i Kontabilitetit

Pjesa 2: Vlera e stokeve në fund për Dafina sh.p.k.

Total Stoqet në fund me kosto (si rrjedhojë e numrimit)	347,841€
Stoqet e shkatërruara aksidentalisht	(4,640€)
Stoqet e dëmtuara – kosto	2,980€
VNR – Çmimi i shitjes minus kostot për t’u realizuar shitja (2,410 – 680)	(1,730€)
Humbja nga rënia në vlerë	<u>(1,250€)</u>
	341,951€

[Total: 20 pikë]